



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:062904

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05714398

C.nr.300/2024

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësve G.Sh., F.Sh. dhe I. Sh.që të gjithë nga fshati V., Komuna e D. (G.), kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: ”Kompensim i dëmit material dhe jo-material”, vlera e kontestit 990.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 21.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** se paditësit G.Sh., F.Sh. dhe I. Sh.që të gjithë nga fshati V., Komuna e D. (G.), e kanë tërhequr padinë që identifikohet në këtë gjykatë me shenjë C.nr.300/2024 të datës 03.01.2024, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit G.Sh., F.Sh. dhe I. Sh.që të gjithë nga fshati V., Komuna e D. (G.), përmes të autorizuarit të tyre Halim Kuliqi avokat në Drenas, me datë 03.01.2024 në këtë gjykatë kanë ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: “Kompensim i dëmit material dhe jo-material”, vlera e kontestit 990.00 euro.

Përfaqësuesi i paditësve, me datë 05.03.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se me të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Eurosig” me seli në Prishtinë, kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, dhe nuk kanë pretendime më për kompensimin e dëmit për aksidentin e datës 17.10.2023, andaj ka kërkuar tërheqjen e padisë së parashtruar pranë kësaj gjykate, ashtu që padia të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni

261 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Bazuar në faktin se paditësit e kanë tërhequr padinë para se të paditurës t’i dërgohet padia me shkresat e lëndës për përgjigje në padi, e në rastin konkret nuk kërkohet pëlqimi i të njëjtit, gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj duke u gjendur në një gjendje të këtillë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.300/2024, datë 21.05.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*